



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:233108
Datë: 08.12.2023
Numri i dokumentit: 05038009

C-IV.-14-4429

Ankuesi:

L G nga Gjakova.

Kundër

Pala kundërshtare:

1.NSH “ Deva” në Gjakovë, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Manushe Karaçi, më 08 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 9 qershor 2014, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka pranuar lëndën C-IV.-14-4429, sipas padisë së parashtruar nga paditësi L G nga Gjakova kundër të paditurës NSH “ Deva ” - Gjakovës për paga të papaguara.

Paditësit theksuan se paraardhësi i tyre, ka qenë pronar i paluajtshmërisë në ngastrën kadastrale nr. ..dhe.., nga fleta poseduese nr... dhe ..(tani fleta poseduese nr. ..ZK Gjakovë), me sipërfaqe

prej 1.47.75 ha, dhe e njëjta është marrë në bazë të aktvendimit të Drejtorisë Komunale Gjakovë për nevojat e Kombinatit “Emin Duraku”

Kësisoj, parashtruesit e padisë kërkuar nga Dhoma e Posaçme që të miratojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar , në mënyrë që të paditurit ë bëjnë kompenzimin për paluajtshmërinë në shumën prej 30.000 euro më kamatë ndëshkuese ligjore nga data 13 maj 1987 deri në pagesën përfundimtare si dhe të kompensoje të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Më 14 nëntor 2023, Dhoma e Posaçme i dërgoi paditësit një urdhër- vërejtje që në afat prej 15 ditëve nga pranimiti i këtij urdhri të paguajë taksën gjyqësore. Poashtu paditësi përmes njoftimit të lëshuar nga gjykata është ftuar që të vijë personalisht në gjykatë, pasi në mungesë të numrit të tij personal , është e pamundur të bashkangjitet formulari i fletëpagesave.

Pas dështimit të dorëzim-pranimit të vërejtjes së gjykatës, në bazë të nenit 26, paragrafi 5 i Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme, nenit 116.5 dhe 116.6 të LPK-së, gjyqtarja e urdhëroi Zyrën e Regjistratit që të afishoj (publikoj) në tabelën e shpalljeve, vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore. Vërejtja e gjykatës qëndroi në tabelën e shpalljeve nga data 6 nëntor 2023 deri më 8 dhjetor 2023.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e parashtruesit konsiderohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në kuptim të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktvendim pa caktuar seancë dëgjimore.

Dhoma e Posaçme, pasi që shqyrtoi ankesën e dorëzuar dhe shkresat e tjera të lëndës konstatoi se ankesa duhet të konsiderohet e tërhequr.

Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur. Ndërsa neni 5.5.2 parasheh që, *"nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas nenit 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen, do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.*

Me nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parashihet që: *'në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore'.*

Rrjedhimisht, Neni 253, paragrafi 253.5 i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

përcakton se: *'Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr'.*

Gjykata ka shfrytëzuar të gjitha rrugët ligjore për të realizuar dorëzimin e vërejtjes te parashtruesi i ankesës për pagesën e taksës gjyqësore, por një gjë e tillë nuk ka qenë e mundur në adresën e dhënë.

Për më tepër, gjykata me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor ka bërë edhe afishimin (publikimin) e vërejtjes në tabelën e shpalljeve me qëllim të informimit të palës në procedurë për përmbushjen e detyrimit në kuptim të pagesës së taksës gjyqësore.

Parashtruesi është i obliguar që ta njoftojë gjykatën për ndërrimin e adresës së vendbanimit siç parashihet me Nenin 116 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, i cili parasheh që: *'Në qoftë se pala ose përfaqësuesi i saj, gjatë zhvillimit të procedurës apo para se të kalojë afati prej gjashtë muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën.'*

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në pajtim me nenin 33 paragrafi 1 dhe nenin 36 paragrafi 2 pika 2.3 e Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet gjyqësore:

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarja
Manushe Karaçi